



# SHFLETO LIBRIN E DEMOKRACISË



## QEVERISJA E POPULLIT

LENDI (13), JONI (12), ONELA (12), EDA (12), KOLOS (12), ART (12), DIJAR (12), LEONIT (12)



### Grupi ynë sot ka diskutuar për demokracinë dhe rolin që e kemi ne si fëmijë në demokraci. Për ta kuptuar më mirë rolin tonë lexojeni artikullin

Ne jemi fëmijë që jetojmë në një vend ku demokracia zbatohet, dhe ku ka ligj e respekt për njëri-tjetrin.


Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke që „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Pra, me një fjalë, demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Demokracia për herë të parë u shfaq në Athinë në vitin 507 para erës sonë.

Janë të njohura dy lloje të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë, populli merr vendime aty për aty, kurse në demokracinë përfaqësuese populli zgjedh përfaqësuesit e vet të cilët pastaj do ta udhëheqin vendin.

Në demokraci njëri nga elementet e rëndësishme është respekti, dhe me zbatimin e tij shteti funksionon më mirë. Element tjetër i demokracisë është edhe barazia, që nënkupton se çdo kush pa dallim feje, race, apo gjinie duhet ti ketë të drejtat e barabarta. Liria është e drejtë themelore e çdo njeriu, e cila përfshinë ndër të tjerash edhe lirinë e shprehjes së mendimit.

Ne sot erdhëm në projektin „Demos-ti“ dhe kemi marrë njohuri se çka është demokracia. Demokracinë mund ta tregojmë me shembuj të ndryshëm: secili prej nesh ka dëshirat e tij rreth gjërave të ndryshme që i pëlqejnë si p.sh. sporti, filmat, muzika, etj. Kjo liri për të zgjedhur mundësohet nga demokracia.

Të drejtat tona na mundësojnë neve që të shprehim mendimet tona lirshëm, të zgjedhim lojërat që neve na pëlqejnë t'i luajmë, të lexojmë librat që dëshirojmë t'i lexojmë, etj.



Respekto rregullat e komunikacionit



Autorët e artikullit

# TI JE AI/AJO QË VENDOS


BLINA (12), BLINË (12), FLANDËR (13), FLORENTINA (13), OLTA (12), MALVINA (12), ODI (13),  
OLTI (12), EDA (12)

**Lexues të dashur, a e keni menduar ndonjëherë se sa të rëndësishme janë zgjedhjet në një shtet demokratik? Këtë do ta mësoni në artikullin më poshtë të shkruar me shumë dashuri për ju**


Zgjedhjet janë baza e demokracisë. Përmes tyre populli ushtron vullnetin për të vendosur për shtetin e vet. Të drejtën për të marrë pjesë në këtë proces kaq të rëndësishëm e kemi nga mosha 18 vjeçare, për arsye se në këtë moshë fillon faza e pjekurisë. E pa dyshim, procesi zgjedhor kërkon marrje të përgjegjësisë dhe aktivizim qytetar. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet komunale. Në zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët (120) që e përfaqësojnë popullin, kurse në zgjedhjet komunale zgjedhen kryetarët e komunave përkatëse dhe assembleistët. Zgjedhjet bëhen çdo 4 vjet dhe bëhen për të mirën e popullit, sepse interesat e popullit në një shtet demokratik janë mbi të gjitha.



Demokratët e së ardhmes




Në demokraci populli ka fuqi për të vendosur



Demokracia të jep liri që të zgjedhësh



E drejta e votës është përgjegjësi që duhet vënë në zbatim



Të gjithë jemi të barabartë në procesin zgjedhor

## PUSHTETI LEGJISLATIV NË KOSOVË

LORENA (12), AGIMI (12), ERMIRA (12), ERINA (12), ESMA (12), EDION (12), ERJON (12),

VALTON (12), ALPI (12)



### Pushtetin legjislativ në Kosovë e ushtron Kuvendi

Grupi ynë, sot ka për të treguar rreth institucionit më të lartë të Republikës së Kosovës, i cili është Kuvendi. Në Kuvend marrin pjesë: deputetët, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministrat e punëve të ndryshme dhe gazetarët.

Në Kuvend miratohen ligjet, por para se këto ligje të miratohen ato propozohen nga: qytetarët, Qeveria, deputetët dhe Presidenti. Duhet të mblidhen rreth 10.000 qytetarë për të propozuar një projektligj. Pastaj, ai projektligj votohet nga deputetët në tri mënyra. Këto mënyra janë: vota e hapur (me dorë), e mbyllur (me shkrim), dhe elektronike.

Kuvendi i Kosovës ka tri funksione: funksionin përfaqësues, funksionin legjislativ dhe funksionin kontrollues. Në krye të këtij institucioni qëndron Kryetari i Kuvendit. Kuvendi ka 120 deputetë, 100 nga ta janë

shqiptarë, kurse 20 të tjerë janë prej komuniteteve të ndryshme që kanë nënshtetësi kosovare, dhe që gëzojnë të drejta të barabarta, ashtu siç edhe ne.

Edhe ne, po të ishim deputetë do bënim shumë ndryshime. Një ngë idetë tona për ndryshim është se do t'i rrisim pagat e mësimdhënësve. Po ashtu, do të dëshironim të ndërtoheshin shkolla dhe konvikte të ndryshme për nxënësit e pastrehët dhe do t'i siguronim libra, fletore dhe mjete të tjera shkollore atyre të cilëve nuk kanë mundësi t'i blejnë. Gjithashtu, do të donim të rregulloheshin shkollat që nuk kanë kushte të mira. Këto ishin idetë tona dhe ajo që kemi përgatitur për ju sot, të dashur lexues.

Por, ne kemi edhe një mesazh për lexuesit tanë: mësoni sa më shumë, jepni më të mirën duke u bërë qytetarë të ndershëm dhe përfaqësues të mirë të shtetit tonë, Kosovës.




Unë si deputet i ardhshëm, do t'i mbaj premtimet



Deputetët e ardhshëm të Kuvendit të Kosovës

# NE PËR NJË VEND DEMOKRATIK

ALB (12), BARDH (12), ANDI (12), BENET (12), ERMIRA (12), LORIKA (12), FESTA (12), ARIOLA (12),  
FATNOR (13)



## Gazetarët kanë për detyrë të marrin më shumë informata për ndodhitë e fundit dhe t'i transmetojnë ato tek qytetarët. Pikërisht këtë gjë do ta bëjmë edhe ne, gazetarët e demokracisë

Kosova është shteti ynë, atdheu ynë. Ne jetojmë në këtë vend dhe kemi detyra dhe obligime për të. Përveç këtyre, ne kemi edhe të drejta. Kosova është një shtet ku jeton dhe vepron demokracia.


Ne të gjithë kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e fjalës, të drejtën e strehimit, etj. Kjo i bie se të gjithë ne, gëzojmë lirinë e plotë në shtetin tonë demokratik. Por, a i keni menduar ndonjëherë obligimet e juaja si qytetarë? Ju qytetarë të dashur, simbolizoni demokracinë që ka Kosova. Ju jeni ata që e udhëheqni vendin tuaj. Marrim një shembull shumë të thjeshtë, zgjedhjet. Vota juaj është shumë e rëndësishme. Deputeti i

votuar nga vet ju është zëri juaj në Kuvend, i cili përfaqëson nevojat dhe interesat tuaja si qytetarë. Qytetar aktiv do të thotë të jesh i interesuar për shtetin tënd. Si mund ta bësh këtë? Këtë mund ta bëjmë duke paguar taksat që të rritet buxheti i shtetit, duke mbajtur mjedisin e pastër, duke bashkëpunuar, vlerësuar dhe respektuar të gjithë qytetarët e tjerë.

Edhe ne si nxënës mund të ndihmojmë në zhvillimin e demokracisë. Secili vend që është demokratik si bazë kryesore e ka arsimin e qytetarëve të vet, kështu që edhe ne si fëmijë mund ta ndihmojmë demokracinë duke u arsimuar që në të ardhmen të jemi edhe më të mençur. Vëre gishtin në kokë dhe mendo se ti e udhëheq vendin tënd dhe je zëri që do ta zhvillosh Kosovën edhe më tej. Faleminderit që e lexuat artikullin tonë.



Gazetarët e demokracisë



Deputetët janë përfaqësuesit e interesave tona



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Selami Hallaçi“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-4  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjiilan

**Kjo kopje nuk është e redaktuar nga Kuvendi i Kosovës**